

*Handbook for Rangers in
Prespa National Park*

*Udhëzuesi i Inspektorëve të
Parkut Kombëtar të Prespës*



August 2013 / Gusht 2013

Elaborated by E.C.O. Institut für Ökologie Jungmeier GmbH

Commissioned by Österreichische Bundesforste AG

Financed by German Financial Co-operation with Albania (KfW and Ministry for Environment, Forestry & Water Administration of Albania)

Translated and verified by Lazjon Petri

Title image © Peter Rupitsch

Proposed citation: Jungmeier, M. & Glatz-Jorde, S., 2013: How to be a good ranger. A handbook for rangers in Prespa National Park. Transboundary Biosphere Reserve Prespa - Support to Prespa National Park in Albania; Capacity Building and Training. Klagenfurt, 113 pp.

Date: August 2013

Punoi: E.C.O. Institut für Ökologie Jungmeier GmbH

Mandatoj: Österreichische Bundesforste AG

Financuar nga: Bashkëpunimi Financiar i Shqipërisë me Gjermaninë (KfW-ja dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë)

Përktheu dhe verifikoi Lazjon Petri

Pamja e Kopertinës © Peter Rupitsch

Propozohet të përdoret ky citim: Jungmeier, M. & Glatz-Jorde, S., 2013: Si mund të bëhesh një inspektor i zoti? Udhëzues për Inspektorët e Parkut Kombëtar të Prespës. Rezerva Ndërkufitare e Biosferës Prespa-Mbështetja për Parkun Kombëtar të Prespës në Shqipëri; Ngritja e Kapaciteteve dhe Trajnimi. Klagenfurt, 113 pp.

Data: Gusht 2013

To the future rangers of Prespa National Parks (PNP).

Për brezat e ardhshëm të inspektorëve të Parqeve Kombëtare të Prespës (PKP).




Table of Contents / Përmbajtja

Preface	11
Hyrje	11
Facts about Prespa and the region / Fakte për Prespën dhe rajonin e saj	12
Which categories apply to PNP?	13
Çfarë kategorie ka PKP?	13
A short overview of the Prespa region	14
Një përshkrim i shkurtër për rajonin e Prespës	14
Which are the important lakes of Prespa region?	15
Cilët janë liqenet kryesorë të rajonit të Prespës?	15
Which islands can be found in the Prespa lakes?	16
Cilët janë ishujt që gjenden në Liqenet e Prespës?	16
How is the water quality of the Prespa lakes?	17
Si është cilësia e ujërave të liqeneve të Prespës?	17
What are the key facts about PNP?	18
Cilat janë faktet kyçe për PKP?	18
What is the reason for the high diversity in PNP?	19
Cila është arsyeja që ka shumëllojshmëri të madhe në PKP?	19
What administrative facts characterize the region?	20
Cilat janë çështjet administrative që karakterizojnë rajonin e Prespës?	20
What is the main source of income for the population?	21
Cili është burimi kryesor i të ardhurave të popullsisë vendase?	21
Which other income opportunities are used?	22
Cilat janë mundësitë e tjera të sigurimit të të ardhurave?	22
Which historical impacts affect the lakes ecosystems today?	23
Cili është ndikimi historik i ekosistemeve të sotshme liqenore?	23
What do you know about the aquatic vegetation in PNP?	24
Çfarë di për bimësinë ujore të PKP?	24
What submerged plant species are growing in Prespa Lake?	25
Cilat bimë rriten në brendësi të ujërave të liqenit të Prespës së Madhe?	25

Which are the typical zones of a lake ecosystem?	26
Cilat janë zonat tipike të ekosistemit liqenor?	26
What are typical vegetation elements of the Micro Prespa Lake?	27
Cilët janë elementët tipikë bimorë të Liqenit të Prespës së Vogël?	27
Do you know the endemic fishes of Prespa Lake?	28
A i njihni shtatë llojet endemike të peshqve të Liqenit të Prespës?	28
Why is Prespa region an important Ramsar site?	29
Pse Rajoni i Prespës është një nga zonat e rëndësishme Ramsar?	29
Which are the most important water bird species of PNP?	30
Cilët janë shpendët ujorë më të rëndësishëm të PKP?	30
Which other important bird species are breeding in PNP?	31
A ka shpendë të tjerë të rëndësishëm që folezizojnë në PKP?	31
How to differentiate the two pelican Species?	32
Nga dallojnë dy llojet e Pelikanëve nga njëri-tjetri?	32
How many breeding birds were counted in PNP?	33
Sa është numri i shpendëve folezizues në PKP?	33
What are the most important vegetation zones?	34
Cilat janë zonat më të rëndësishme të bimësisë?	34
Which Oak species characterize the Oak Zone in PNP?	35
Cilët janë Dushqet që karakterizojnë zonën e Dushqeve në PKP?	35
How to differentiate the oak species by their leaves?	36
Si të bësh dallimin e llojeve të Dushqeve duke u nisur nga ndryshimi i gjetheve të tyre?	36
Which other vegetation elements are important in the oak zone?	37
Cilët janë elementët e tjerë bimorë të rëndësishëm të zonës së Dushqeve?	37
What is the Phrygana or “Shiblyak”?	38
Çfarë është Phrygana ose “Shiblyaku”?	38
What are the characteristics of the vegetation of the beech zone?	39
Cilat janë karakteristikat e bimësisë së zonës së Ahut?	39
Which plant species are those?	40
Si quhen këto bimë?	40
Which are typical orchids of PNP?	41
Cilat janë orkidetë tipike të PKP?	41

Which are the most prominent mammals of PNP?	42
Cilët janë gjitarët më të rëndësishëm të PKP?	42
How many endangered mammals live in PNP?	43
Sa është numri i gjitarëve të PKP që "rezikohen" të zhduken?	43
Which are the most important reptiles of PNP?	44
Cilët janë zvarranikët më të rëndësishëm e PKP?	44
Which types of snake live in PNP?	45
Kush janë gjarpërinjtë e PKP?	45
How do Herman's Tortoise live?	46
Si jeton Breshka e Zakonshme?	46
What are the main factors threatening tortoises?	47
Cilet jane faktoret kryesore te kercenimit te breshkave?	47
Which are typical amphibians of PNP?	48
Cilet jane amfibet tipike te PKP?	48
Which are the four frog species of PNP?	49
Sa lloje bretkocash ka PKP?	49
What are the main dangers for the PNP?	50
Cilat janë rreziqet më të mëdha për PKP?	50
What is the reason for illegal cutting?	51
Kush është arsyeja e prerjes pa lejë të druve?	51
Do you know a local animal breed?	52
Kafshë të racës vendase?	52
What local specialities would you recommend?	53
Specialitetet e zones	53
Which are the most common edible plants of the Prespa forest?	54
Bimët e ngrënëshme	54
Which medical plants are commonly used?	55
Cilat janë bimët mjekësore që përdoren më tepër?	55
What are the most important sight seeing places of the region?	56
Cilat janë vëndet më turistike në zonën e Prespës?	56
What are the most interesting landscapes of the region?	57
Cilat jane peizazhet me tërheqëse të rajonit?	57

Legal Framework of PNP / Kuadri Ligjor i PKP	58
What is the Balkan Green Belt?	59
Çfarë është Brezi i Gjelbër i Ballkanit	59
What is the aim of PNP?	60
What is the mission statement of PNP administration?	60
Kush është qëllimi i PKP?	60
Kush është deklarata e Misionit e administratës së PKP?	60
What is a biosphere reserve?	61
Çfarë është Rezerva e Biosferës?	61
How is the administration of PNP organized?	62
Si është e organizuar administrata e PKP?	62
What different park specialists does PNP need?	63
Për cilët specialistë ka nevojë PKP?	63
Which laws determine the legal frame of the PNP?	64
Cilat ligje përcaktojnë kuadrin ligjor të PKP?	64
What are the main duties of the administration office of the protected areas?	65
Cilat janë detyrimet kryesore të administratave të Zonave të Mbrojtura?	65
Which duties of the administration office address visitors and the local population?	66
Cilat janë detyrimet e administratës së Zonës së Mbrojtur, të cilat i adresohen vizitorëve dhe popullsisë lokale?	66
Which services should the office administration provide?	67
Cilat janë shërbimet që duhet të kryejë administrata?	67
Which activities are definitely forbidden in a national park?	68
Cilat veprimtari ndalohen të kryhen në një PKP?	68
What activities are allowed with an environmental permit only?	69
Cilat veprimtari lejohen të kryhen vetëm nëse janë të pajisura me leje mjedisore?	69
Which activities can be approved by the national park administration?	70
Cilat janë veprimtaritë që mund të miratojë administrata e Parkut Kombëtar?	70
Which law regulates the use of national forest land?	71
Cili ligj ka për objekt përdorimin e tokës së pyjeve shtetërorë?	71
What principles are the base for the activities in the national forest?	72
Cilat janë parimet që përbëjnë bazën e veprimtarive në pyjet shtetërore?	72

What is the main function of the Forest police?	73
Cilat janë funksionet kryesore të Policisë Pyjore?	73
What other tasks do the Forest Police have?	74
Çfarë detyrime të tjera ka Policia Pyjore?	74
How to deal with forest infringement?	75
Çfarë duhet bërë kundrejt shkeljes së ligjeve të pyjeve?	75

Knowledge about Nature Conservation /

Njohuri rreth ruajtjes se natyres

76

What are important stepstones in nature conservation history?	77
Cilat janë ngjarjet kyçe në historinë e ruajtjes së natyrës?	77
Do you know the IUCN Categories?	78
I njihni Kategoritë e IUCN-së?	78
What is the difference between IUCN categories I and II	79
Cili është dallimi midis kategorive të para dhe të dyta të IUCN-së	79
What is the character of IUCN Category V?	80
Çpërmban Kategoria e V ^{te} e IUCN-së?	80
What is the aim of the Ramsar Convention?	81
Cili është qëllimi i marrëveshjes Ramsar?	81
What are the three pillars of the Ramsar Convention?	82
Cilat janë tre shtyllat e marrëveshjes Ramsar?	82
What is the “Wise Use” concept	83
Cili është koncepti i “Përdorimit me Zgjuarsi”	83
How is Biodiversity defined?	84
Si është përcaktuar Biodiversiteti?	84
Do you know the global biodiversity hot spots?	85
A i njihni pikat e nxehta të Biodiversitetit?	85
How many species are known worldwide?	86
Sa lloje njhen botërisht?	86
What are the top threats to biodiversity?	87
Cilët janë kërcënimet kryesore të biodiversitetit?	87
How is biodiversity loss measured?	88
Si matet humbja e Biodiversitetit ?	88

What is the Island biogeography about?	89
Çfarë janë ishujt biogeografikë?	89
When are species called “rare”?	90
Kur llojet quhen “të rralla”?	90
When is the probability for extinction high?	91
Kur është e lartë mundësia e zhdukjes?	91
What is a Red list?	92
Çfarë është një listë e Kuqe?	92
How is the conservation status of IUCN species?	93
Si është statusi i ruajtjes së Llojeve të IUCN?	93
What are the components of an ecosystem?	94
Cilët janë përbërësit e një ekosistemi?	94
Can you give a food chain example?	95
Mund të jepni një shembull të një zinxhiri ushqimor?	95
How is the energy flow in an ecosystem?	96
Si rrjedh energjia në një ekosistem?	96
What are keystone species?	97
Çfarë janë llojet kyçe?	97
Which factors determine a forest ecosystem?	98
Cilët faktorë përcaktojnë një ekosistem pylli?	98
Whats the interrelation between CO ₂ emission and climate change?	99
Cila është lidhja midis lëshimit të CO ₂ dhe ndryshimit të klimës?	99
How will global warming affect ecosystems?	100
Si po ndikon tek ekosistemet ngrohja globale?	100

Important skills of a ranger /

Aftësitë e nevojshme për inspektorët 101

What are the tasks of a national park ranger?	102
Cilat janë detyrat e inspektorit të PKP?	102
What are important skills of a good ranger?	103
Cilat janë aftësitë e nevojshme që duhet të ketë një inspektor?	103
How to plan a guided tour?	104
Si të planifikoni një guidë?	104

What to show on a guided tour?	105
Çfarë duhet t'u tregosh të pranishmëve gjatë një guide?	105
How to get visitors involved?	106
Si mund t'i përfshish edhe vizitorët?	106
What equipment does a ranger need?	107
Cilat janë pajisjet që i duhen inspektorëve?	107
First aid – Frequent problems and what to do?	108
Kutia e ndihmës së shpejtë – Problemet që hasen më tepër dhe si të veprosh në të tilla raste?	108
How to fill a first aid kit?	109
Çfarë duhet të përmbajë kutia e ndihmës së shpejtë?	109
The most important emergency numbers	110
Numrat e Urgjencës	110
Abbreviations	111
References	112

Preface

After a two years period of capacity building and training of the Prespa National Park staff the trainees expressed the wish to do an exam. This handbook offers a summary of the topics discussed during the training sessions in Prespa National Park. It can additionally be used as stimulation for organising guided tours in the region.

It provides an overview of the fields of the essential knowledge of rangers: Knowledge about the area and the region, knowledge about the legal framework of the protected area, a general understanding of nature conservation, and last but not least the knowledge about tasks and responsibilities of a ranger service.

The handbook is considered to be a living document. It shall be adapted, continued or revised any time. Thus, it shall become a knowledge-base for staff members and also new members in the team.

Hyrje

Pas një harku kohor prej dy vitesh, gjatë të cilëve është punuar në mënyrë të veçantë për ngritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e stafit të Parkut Kombëtar të Prespës, personat e trajnuar shprehën një dëshirë: -“Të bënin një provim, si mënyra më e mirë e testimit të njohurive të përfutuara”. Në këtë përmbledhje paraqiten temat e diskutuara gjatë seancave të trajnimeve në Parkun Kombëtar të Prespës, të cilat mund të përdoren si shtysa në bërjen e guidave natyrore.

Në këtë udhëzues inspektorët do të kenë mundësi të ballafaqohen me njohuritë kryesore të nevojshme për punën e tyre: marrjen e dijeve për zonën e parkut dhe për kuadrin ligjor të zonave të mbrojtura; të kuptuarit e ruajtjes së natyrës në përgjithësi dhe për më tepër marrjen e njohurive rreth detyrave dhe përgjegjësi të shërbimeve të inspektorëve.

Ky udhëzues përfaqëson një libër të hapur për t’u përshtatur dhe rishikuar në të ardhmen në mënyrë që t’i shërbejë sa më mirë marrjes së njohurive të stafit të sotshëm por edhe anëtarëve të rinj të ekipit.

Facts about Prespa and the region

Fakte për Prespën dhe rajonin e saj



Fig. 1: Prespa Lake (© MJ)/ Liqeni i Prespës

Which categories apply to PNP?

National Park (IUCN Category II)

Ramsar site

Proposed bilateral biosphere reserve with the Pelister National Park and Galicica National Park (both in Macedonia).

Çfarë kategorie ka PKP?

Park Kombëtar (Kategoria II sipas IUCN-së)

Zonë Ramsar

E propozuar për Basen Dypalësh i Biosferës (apo Rezervë Bilaterale e Biosferës) mes PKP në Shqipëri dhe Parkut Kombëtar të Pelisterit dhe Galicica-s në Maqedoni.




Fig. 2: Map of Prespa National Park (Source: Grazhdani, 2010) / Harta e Parkut Kombëtar të Prespës (Burimi: Grazhdani, 2010)

A short overview of the Prespa region

The Prespa-Ohrid region is situated in the eastern-most part of Albania, bordering Greece and Macedonia. The mountainous area is dominated by the two large lakes that are connected subterraneously. The climate is Mediterranean continental.

Large and Small Prepa lake are separated by a small “bridge” of land.




Fig. 3. Overview of the Prespa region (Source: google maps).

Një përshkrim i shkurtër për rajonin e Prespës

Rajoni Ohër-Prespë shtrihet në pjesën më lindore të Shqipërisë, në kufi me Greqinë dhe Maqedoninë (FYROM). Kjo zonë malore ka në gjirin e saj dy liqene të mëdha të cilat ndërlidhen nga ujërat nëntokësore. Klima është Mesdhetare Kontinentale.

Liqeni i Prespës së Madhe ndahet nga liqeni i Prespës së Vogël nga një “urë” e vogël toke.

Which are the important lakes of Prespa region?

The Great and the Micro Prespa Lakes cover parts of Albania, Greece, and Macedonia. The third large lake in the region is called Lake Ohrid; it connects Albania and Macedonia.

The nations' share in the Great Prespa Lake are:

- Macedonia: 60 per cent,
- Albania: 20 per cent,
- Greece: 20 per cent.

Cilët janë liqenet kryesorë të rajonit të Prespës?

Liqeni i Prespës së Madhe dhe Liqeni i Prespës së Vogël shtrihen përgjatë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, Greqisë dhe Maqedonisë. Ndërsa Liqeni i Ohrit ndodhet ndërmjet kufijve shtetërorë të Shqipërisë dhe Maqedonisë. Sipërfaqet liqenore të Liqenit të Prespës së Madhe për tre shtetet ndërkufitare janë përkatësisht:

- Maqedonia: 60%,
- Shqipëria: 20%,
- Greqia: 20%.



Fig. 4: Impression of Large Prespa Lake (© MJ) / Pamje e Liqenit të Prespës së Madhe

Which islands can be found in the Prespa lakes?

In Great Prespa Lake there are two islands: Golem Grad in Macedonia and Maligrad in Albania. The latter belongs to the core zone of Prespa National Park and is uninhabited. On the picturesque Snake Island (Maligrad) there are the ruins of the old St. Marie's church, a basilica built in the XIVth Century. Situated in a rocky cavern, it is known for its beautiful Byzantine mural pictures. Micro Prespa has three islands named Pirg, Agios Achillios, Vidronisi, which are situated in Greece.

Cilët janë ishujt që gjenden në Liqenet e Prespës?

Në liqenin e Prespës së Madhe ka dy ishuj: Golem Grad-i në Maqedoni dhe Maligradi në Shqipëri. Ky i fundit ndodhet në zonën qëndrore të Parkut Kombëtar të Prespës dhe është i pabanueshëm. Në ishullin piktoresk të Gjarpërinjve (Maligrad) gjenden rrënojat e kishës së vjetër të Shën Marisë, bazilikës së ndërtuar në shekullin e XIV. Kjo kishë e famshme për pikturat e saj murale Bizantine ndodhet pikërisht brenda një zgavre shkëmbore të këtij ishulli. Ndërsa në liqenin e Prespës së Vogël ndodhen tre ishuj: Pirg, Agios Achillios dhe Vidronisi, të cilët janë në pjesën Greke.



Fig. 5: Impression of Mali Grad Island in Lake (© MJ) / Pamje e ishullit të Mali Gradi-t

How is the water quality of the Prespa lakes?

Because Great Prespa Lake sits about 150 metres above Lake Ohrid, which lies only about ten kilometres to the west, its waters run through underground channels in the karst and emerge from springs, which feed streams running into Lake Ohrid, which is one of the nutrient-poorest lakes of the world.

Name	Size	Altitude (m.a.s.l.)	Nutritional value
Great Prespa Lake	285 km ²	845 m	oligo to mesotroph
Micro Prespa	44 km ²	845-850 m	eutroph
Ohrid Lake	359 km ²	695 m	oligotroph

Fig. 6: Overview on the size, altitude, and the nutritional value of the different lakes (Source: Fremuth et al. 2008).

Si është cilësia e ujërave të liqeneve të Prespës?

Liqeni i Prespës së Madhe ndodhet rreth 150 m mbi Liqenin e Ohrit, i cili shtrihet 10 km më në perëndim.

Kështu, ujërat e liqenit të Prespës së Madhe, derdhen në liqenin e Ohrit, nëpërmjet kanaleve nëntokësore të karstit, duke bërë që ujërat nëntokësore së bashku me përrenjtë malorë të ushqejnë këtë liqen (të Ohrit), i cili është një nga liqenet më të varfra në botë, përsa i takon lëndëve ushqyese.

Emri	Sipërfaqja	Lartësia (m.n.d)	Niveli trofik
Liqeni i Prespës së Madhe	285 km ²	845 m	oligo - mezotrof
Liqeni i Prespës së Vogël	44 km ²	845-850 m	eutrof
Liqeni i Ohrit	359 km ²	695 m	oligotrof

Fig. 7: Të dhënat e niveleve trofike, sipërfaqeve dhe lartësive mbi nivelin e detit të këtyre liqeneve (Burimi i informacionit: Fremuth et al. 2008).

What are the key facts about PNP?

Foundation: in 2000;

Size: 27 450 hectares; Prespa National Park is one of the biggest national parks in Albania;

Highest elevation: 2287 metres; reached by the peak iPllaja e Pusit in the mountains Mali i Thate;

Size of Great Prespa Lake: 285 km²;

Maximal depth: Great Prespa Lake: 54 metres; Micro Prespa: 7.7 metres;

Cilat janë faktet kyçe për PKP?

Themelimi: Në vitin 2000;

Sipërfaqja: PKP ka një sipërfaqe prej 27 450 ha dhe është Parku Kombëtar më i madh i Shqipërisë;

Maja më e lartë: 2287 m, Mali i Thate, në të cilin, maja më e lartë është Pllaja e Pusit;

Sipërfaqja e Liqenit të Prespës së Madhe: 285 km².

Thellësia maksimale: Liqenit të Prespës së Madhe: 54 m; Liqenit të Prespës së Vogël: 7.7 m;



Fig. 8: Impressions from Prespa National Park (©: MJ) / Pamje nga Parku Kombëtar i Prespës

What is the reason for the high diversity in PNP?

Prespa National Park is situated in the Sub Mediterranean Zone. The high diversity of the vegetation in Prespa depends on the elevation, exposition, geology and soil. There are Mediterranean, middle European, alpine and continental, as well as Asian floral elements. Especially the limestone mountains Mali i Thate, situated between Ohrid Lake and Prespa Lakes, shelter all this vegetation elements.



Cila është arsyeja që ka shumëllojshmëri të madhe në PKP?

Prespa ndodhet në zonën Sub-mesdhetare. Shumëllojshmëria e lartë bimore në Prespë varet nga lartësia mbi nivelin e detit, ekspozimi, gjeologjia dhe toka. Aty rriten elementë të florës Mesdhetare, të Evropës qendrore, alpine, kontinentale dhe Aziatike. Prania e këtyre elementëve floristikë bëhet edhe më e mundur veçanërisht sepse Mali i Thatë që ndodhet midis liqenit të Ohrit dhe atij të Prespës është i pasur me shkëmbinj gëlqerorë.

Fig. 9: Diversity of altitudinal zones (© JM) / Larmia e zonave me lartësi të ndryshme nga niveli i detit

What administrative facts characterize the region?

The region's name is Liqenasi, represented by the Liqenas Commune. During the latest census (2011), on the Albanian side 5,634 persons living in 12 villages have been counted around the two Prespa lakes.

The Centre of the Province is Korçë with around 85,000 inhabitants. Besides its role as infrastructural centre with educational facilities, hospital, a theatre, and some museums it offers a multifaceted cultural life. It is around 45 km away from the Prespa National Park, whose headquarters is in Gorica e Vogël.

Cilat janë çështjet administrative që karakterizojnë rajonin e Prespës?

Komuna që ka peshën më të madhe të rajonit të Prespës është Pusteci (Liqenasi). Rezultatet e censusit të fundit të popullsisë dëshmojnë se popullsia e 12 fshatrave të vendosura përreth dy liqeneve të Prespës dhe që janë pjesë e PKP është 5,634.

Qendra e Prefekturës është qyteti i Korçës, me një popullsi prej 85,000 banorësh. Ky qytet, i cili ndodhet 45 Km larg nga Parku Kombëtar i Prespës (apo nga stacioni i qendrës së administratës në Goricë të Vogël) është i mirënjohur për jetën kulturore në përgjithësi dhe për praninë e teatrit, muzeve, spitalit dhe institucioneve arsimore në veçanti.

What is the main source of income for the population?

Farming and animal husbandry (especially goats, sheep, cattle, and horses/donkeys) are the pillars of people's livelihood in the region. 7,000 domestic animals were counted in the year 2008. The second source of income is fishing.

The Albanian part of the Micro Prespa is also used for fishing and hunting of water birds. In summer time, when water fully withdraws, a part of the wetland's surface is used for cultivating vegetables and forages or is conserved and used for pastures. Canes growing in the wetlands are used in construction and handcrafts (Panariti et al., 2008).

Cili është burimi kryesor i të ardhurave të popullsisë vendase?

Shtyllat e jetesës së njerëzve të këtij rajoni janë bujqësia dhe blegtoria (veçanërisht dhitë, delet, lopët dhe kuajt/gomerët). Në vitin 2008 u numëruan rreth 7000 kafshë shtëpiake. Burim tjetër i rëndësishëm të ardhurash për popullsinë vendase është peshkimi.

Edhe pjesa shqiptare e liqenit të Prespës së Vogël përdoret për veprimtaritë e peshkimit dhe gjuetisë së shpendëve ujqorë. Gjatë kohës së verës, me tërheqjen pothuajse të plotë të ujit të liqenit, një pjesë e mirë e këtyre tokave ligatinore përdoret për kultivimin e perimeve dhe tagjisë ose ruhet për kullotje. Kalamat që rriten në këtë mjedis përdoren në dërtim dhe për punime artizanale (Panariti et al., 2008).

Which other income opportunities are used?

The livelihood of the villages around the lake strongly depends on the well-being of the lake: Residents count on the lake as a source of their drinking water, cleaning water, fishing, irrigation, as well as for husbandry feeding and rest. Lake based activities are mainly practiced during summer time, while during winter time many men spend in migration as an additional source of income.

Many people commute to Korça or seasonally migrate. Since the establishment of Prespa National Park, nature based tourism is becoming an additional option. Other income opportunities are medicinal plants, mountain tea and mushroom collections. Beekeeping is a common activity as well.

Cilat janë mundësitë e tjera të sigurimit të të ardhurave?

Jetesa e fshatrave përreth liqenit është varet tërësisht nga mirëqenia e liqenit: Banorët përdorin ujin e liqenit për pirje, larje, ujtitje, peshkim, për të ushqimin dhe mbarështimin e kafshëve blegtorale, por edhe për të pushuar (për t'u çlodhur). Veprimtaritë që janë të lidhura pazgjidhshmërisht me liqenin kryhen gjatë kohës së verës, ndërsa gjatë dimrit shumë njerëz migrojnë për të siguruar një burim shtesë të të ardhurave.

Shumë njerëz të rajonit të Prespës janë shpërngulur në qytetin e Korçës dhe disa syresh migrojnë përkoheësisht. Duke qënë se me themelimin e Parkut Kombëtar të Prespës, po rritet përherë e më shumë mundësia e zhvillimit të turizmit natyror. Në këtë kuadër, një mundësi tjetër e sigurimit të të ardhurave është mbledhja e bimëve mjekësore, çajit të malit dhe kërpudhave. Një aktivitet tjetër i zakonshëm për këtë rajon është bletaria.

Which historical impacts affect the lakes ecosystems today?

During socialist times, the hydro-technical system of Micro Prespa was constructed. It includes pumps and canals, which brought water into the Micro Prespa Lake in winter and took water from the lake to irrigate the Korça Fields in summer. This led to an accumulation of sediments in the lake and damaged the fish spawning grounds. At the same time it has polluted the lake with agricultural chemicals. On the other hand the irrigation has reduced the lakes' level by transforming part of them into marshlands (Panariti et al., 2010). Nevertheless, during the last decade, actions have been taken, at least at the policy level, aiming to improve the situation with such important eco-regions such as the complex of the Prespa Lakes.

Cili është ndikimi historik i ekosistemeve të sotshme liqenore?

Gjatë kohës së monizmit, u ndërtua sistemi hidro-teknik i liqenit të Prespës së Vogël. Ky sistem përfshinte pompa dhe kanale, që sillnin ujë gjatë dimrit në Liqenin e Prespës së Vogël dhe merrnin ujë nga liqeni gjatë verës për të ujitur tokat e fushës së Korçës. Kjo bëri që të grumbulloheshin sedimente në liqen dhe të dëmtoheshin vendet e hedhjes së vezëve të peshkut. Në të njëjtën kohë uji i liqenit u ndot nga kimikatet bujqësore. Nga ana tjetër sistemi ujitjes bëri që të ulej niveli i këtij liqeni dhe të krijoheshin kushtet për kënetëzim (Panariti, 2008). Megjithatë, gjatë dekadës së fundit, janë ndërmarrë veprime, të paktën në nivelin politik, me qëllim përmirësimin e situatës të këtij eko-rajoni të rëndësishëm, që është pjesë përbërëse e kompleksit të Liqeneve të Prespës.

What do you know about the aquatic vegetation in PNP?


The vegetation of the lakes consists of typical elements: Reed belts, aquatic plants, and submerse plants. In shallow areas of the lakes there are still reed belts left. Typical plants are the Common reed (*Phragmites australis*), Broadleaf cattail (*Typha latifolia*) and Simplestem bur-reed (*Sparganium erectum*). The common water crowfoot (*Ranunculus aquatilis*) is widely spread. The common goat's rue (*Galega officinalis*) frequently grows at the lake shore.

Çfarë di për bimësinë ujore të PKP?

Bimësia e liqeneve përbëhet nga këta elementë tipikë: rripat e kallamave, bimët ujore notuese dhe bimësia nënujore. Në zonat e cekëta të Liqeneve ka ende rripa kallamash. Bimësia tipike e këtyre mjediseve është ajo e kallamit të zakonshëm (*Phragmites australis*), shavari gjethegjerë (*Typha latifolia*) dhe Spranga e Ngritur (*Sparganium erectum*). Zhabina e zakonshme e ujit (*Ranunculus aquatilis*) është e përhapur gjerësisht. Ndërsa bari i zakonshëm i Qerbashit (*Galega officinalis*) rritet shpesh në breg të liqenit.

What submerged plant species are growing in Prespa Lake?

The Water Chestnut (*Trapa natans*) is an endangered submerged plant species, which occurs at Great Prespa Lake at Kallamas, Gorica e Vogel, and Golomboç Bay. Other more common submerged species are Pondweed (*Potamogeton species*) and Tape Grass (*Vallisneria spiralis*).



Cilat bimë rriten në brendësi të ujërave të liqenit të Prespës së Madhe?

Një lloj bimor ujqor i rrezikuar që gjendet buzë liqenit të Prespës së Madhe, në Kallamas, në Goricë të Vogël dhe në gjirin e Gollomboçit, është gështenja e ujit (*Trapa natans*). Lloje të tjera bimore ujore të këtij rajoni janë ato të gjinisë Potamogeton apo Shiritat e barit (*Vallisneria spiralis*).

Fig. 10: Drawing by Otto Wilhelm Thome / Vizatuar nga Otto Wilhelm Thome (<http://www.classicnatureprints.com/pr.Thome%20Flora/t.trapa.natans.jpg>)

Which are the typical zones of a lake ecosystem?

A lake consists of typical zones. The

Cilat janë zonat tipike të ekosistemit liqenor?

Një liqen përbëhet nga disa zona tipike. Bregu i liqenit së bashku me llojet bimore që rriten aty njihet




Fig. 11: Typical zones of a lake ecosystem (© Glatz) / Zonat tipike të ekosistemit liqenor.

What are typical vegetation elements of the Micro Prespa Lake?

In the last decades, the Albanian part of Micro Prespa Lake has been transformed into wetlands. Its surface varies during the year caused by natural evaporation and irrigation for agriculture.

Typical aquatic plants of the Micro Prespa are the white and the yellow Water Lilies (*Nymphaea alba* and *Nuphar lutes*). Also the Yellow Floating Heart (*Nymphaoides peltata*) is widely spread as well as the Common Water Crowfoot (*Ranunculus aquatilis*).



Fig. 12: The Water Crowfoot as typical plant of shallow water and amphibic habitats (© MJ) / Zhabina e është një nga bimët tipike të ujërave të cekta dhe të habitateve të amfibëve

Cilët janë elementët tipikë bimorë të Liqenit të Prespës së Vogël?

Në dekadat e fundit, pjesa shqiptare e liqenit të Prespës së Vogël është transformuar në një ligatinë, sipërfaqja e së cilës ndryshon gjatë vitit, falë avullimit natyrorë ose ujitjes së tokave bujqësore.

Bimët tipike ujore të Prespës së Vogël janë Zambakët e bardhë dhe të verdhë Ujorë (*Nymphaea alba* dhe *Nuphar lutea*). Të pranishme janë gjithashtu edhe Zemra e verdhë pluskuese (*Nymphaoides peltata*) apo Zhabina e zakonshme e ujit (*Ranunculus aquatilis*).

Do you know the endemic fishes of Prespa Lake?

Prespa National Park hosts a big number of endemic species. An endemic species occurs only at a defined, limited and small geographic area. Eight endemic fish species live in Prespa Lake. They were scientifically described in the year 1924 (Karaman, 1924).

A i njihni shtatë llojet endemike të peshqve të Liqenit të Prespës?

Në PKP ka një numër të madh llojesh endemikë. Një lloj quhet endemik, kur ndodhet vetëm në një vend të përcaktuar dhe të kufizuar në një zonë të vogël gjeografike. Kështu në liqenet e PKP ka disa lloje peshqish endemikë. Karaman, në vitin 1924 bëri shpjegimin shkencor të tyre.









Name / Emri	Image / Shëmbëlltyra	Conservation status / Statusi i ruajtjes
Prespa trout / Trofta e murme e Prespës (<i>Salmo truta prespensis</i>)		Endangered / I rrezikuar
Prespa barb / Mrena e Prespës (<i>Barbus prespensis</i>)		Vulnerable / I përkeqsuar
Prespa nase / Njila e Prespës (<i>Chondrostoma nasus prespensis</i>)		Vulnerable / I përkeqsuar
Prespa Roach / Skorta e Prespës (<i>Rutilus prespensis</i>)		Vulnerable / I përkeqsuar
Prespa spirling / Cironka e Prespës (<i>Alburnoides prespensis</i>)		Vulnerable / I përkeqsuar
Prespa Bleak / Gjuca e Prespës (<i>Alburnus belvica</i>)		Vulnerable / I përkeqsuar
Prespa Chub / Mëlyshi i Prespës (<i>Squalius prespensis</i>)		Least concern / Rrezik të ulët
Prespa Minnow / Grunci Prespës (<i>Pelagus prespensis</i>)		Endangered / I rrezikuar

Fig. 13: Overview on the conservation status of the endemic fish species in Prespa Lake (Society for the Protection of Prespa 2013) / Paraqitja e statusit të ruajtjes së peshqve endemikë të Liqenit të Prespës (Shoqata për Mbrojtjen e Prespës, 2013)

Why is Prespa region an important Ramsar site?

The Prespa Lakes are an important winter habitat for the palaeartic water birds. According to the census of wintering water birds in the years 1997 – 2000, around 40,000 individuals of 25 bird species winter in Prespa National Park. For example 30,000 individuals of the Eurasian Coot (*Fulica atra*) were reported in the year 1999. 2,000 individuals of Black-necked grebe (*Podiceps nigricollis*), Tufted Duck and Common Pochard (*Athya fuligula* and *Athya farina*) different teal species (*Anas platyrhynchos* and *Anas crecca*) were counted.



Fig. 14: The Prespa Lakes are an important Ramsar site (© MJ) /
Liqenet e Prespës janë zona të rëndësishme Ramsar

Pse Rajoni i Prespës është një nga zonat e rëndësishme Ramsar?

Liqenet e Prespës, gjatë dimrit shërbejnë si habitate të rëndësishme për shpendët ujorë të zonës palearktike. Sipas numërimeve të shpendëve ujorë dimërorë të viteve 1997 – 2000, në Parkun Kombëtar të Prespës dimërojnë rreth 40,000 individë të 25 llojeve. Kështu në vitin 1999 u raportuan 30,000 individë *Fulica atra* (Bajza) si dhe 2,000 individë *Podiceps nigricollis* (kredharaku gushëzi), *Athya fuligula* (Rosa laramane me çafkë) dhe *Athya ferina* (kryekuqja e mjeme), por në të njëjtën kohë u hasën edhe *Anas platyrhynchos* (Rosa e egër, i gjelbër: mashkulli; e kuqe: femra) dhe *Anas crecca* (Rosa kërre/kërrkërrja/gërxfhola).

Which are the most important water bird species of PNP?

Prespa provides shelter to over 200 species of birds, many of which belong to rare or declining populations within Europe. It contains the largest breeding colony of the vulnerable Dalmatian pelicans (*Pelecanus crispus*) in the world, a mixed colony of pelicans also with the Great white Pelican (*Pelecanus onocrotalus*) and the largest colony of Pygmy Cormorans (*Phalacrocorax pygmaeus*) in Europe. The Ferruginous Duck (*Aythya nyroca*), which feeds at night dabbling for food, is classified as “near threatened” according to the IUCN Red List.



Fig. 15: Flying pelican (© MJ) / Pelikani në fluturim

Cilët janë shpendët ujorë më të rëndësishëm të PKP?

Në Prespë janë vëzhguar rreth 200 lloje shpendësh, shumë prej të cilëve u përkasin popullatave të rralla ose atyre në rënie të Evropës. Pikërisht në këtë liqen folezohet kolonia më e madhe në botë e Pelikanit Kaçurrel (*Pelecanus crispus*) me status të përkeqësuar, e cila përziejhet me koloninë e Pelikanëve Rozë (*Pelecanus onocrotalus*) dhe me koloninë më të madhe në Evropë të Karabullakut të Vogël (*Phalacrocorax pygmaeus*). Sipas listës së kuqe të IUCN-së, rosa *Aythya nyroca* ose siç quhet në shqip Kryekuqja e Vogël ka status ruajtje: Pothuajse e Kërcënuar. Kjo rosë del natën dhe bubërron në liqenin e Prespës së Madhe.

Which other important bird species are breeding in PNP?

The Golden Eagle (*Aquila chrysaetos*) and the Asian Imperial Eagle (*Aquila helica*) were also observed in Prespa National Park. The latter is listed as “vulnerable” at the IUCN Red List because it has a small global population, and is declining globally as a result of habitat loss and degradation.

The Peregrin Falcon (*Falco peregrinus*) is one of the 53 breeding birds of Prespa National Park.

A ka shpendë të tjerë të rëndësishëm që folenizojnë në PKP?

Në PKP është vrojtuar edhe Shqiponja e Malit (*Aquila chrysaetos*) apo Shqiponja Perandorake (*Aquila heliaca*). Kjo e fundit është përfshirë në listën e IUCN-së me status: E përkeqësuar, pasi jo vetëm që ka mbetur një popullsi e vogël e saj, por është gjithmonë në rënie në nivel botëror si pasojë e humbjes dhe degradimit të habitateve.

Një prej 53 llojeve të shpendëve folenizues të PKP është edhe Kra-hëthati (*Falco peregrinus*).



Fig. 16: Dalmatian pelican (© Marko Jankovic, download from PNP on Facebook) / Pelikani Kaçurrel (© Marko Jankovic, foto e shkarkuar nga Facebook-u i PKP)

How to differentiate the two pelican Species?

The biggest Pelican species is the Dalmatian Pelican (*Pelecanus crispus*). Its weight goes up to 13 kg. It needs 1 kg of fish per day. Its feathers are silver white. It has grey legs and an orange-red throat sack. It hunts in groups and chases fish in the shallow water, where fish can be easily picked.

In contrast, the Great White Pelican (*Pelecanus onocrotalus*) has rose coloured feathers and black wing feathers. Its throat sack is yellow. It lives in huge colonies.

Nga dallojnë dy llojet e Pelikanëve nga njëri-tjetri?

Më i madhi mes tyre në përmasa është Pelikani Kaçurrel (*Pelecanus crispus*). Peshë e tij shkon deri në 13 kg. Pelikani kaçurrel ushqehet me rreth 1 kg peshq në ditë. Pendët i marrin ngjyrë të bardhë në të argjendtë. Këmbët i ka ngjyrë gri, ndërsa në gushë mbizotërojnë e kuqja dhe portokallia. Ky pelikan gjuan në grup dhe kap peshq në ujëra të cekëta (atje ku peshqit mund të zihen me më lehtësi).

Pelikani Rozë (*Pelecanus onocrotalus*) është i dallueshëm kryesisht nga ngjyra rozë e pendëve dhe nga puplat e tij të zeza në pjesën e krahëve. Në ndryshim nga Pelikani Kaçurrel, Pelikani Rozë e ka gushën të verdhë. Ky pelikan jeton në koloni shumë të mëdha.

How many breeding birds were counted in PNP?

1997 and 1999 breeding birds were observed in the Prespa Region during a scientific research project. 53 species were counted. The Common Starling (*Sturnus vulgaris*), Eurasian Linnet (*Carduelis cannabina*), *Carduelis carduelis* and Eurasian Skylark (*Alauda arvensis*) with more than 130 individuals were most frequently reported. In total 1494 individuals were counted according to Freemuth et al (2008).

Sa është numri i shpendëve folenizues në PKP?

Në kuadër të një projekti studimor shkencor janë vrojtuar dhe numëruar 53 lloje shpendësh folenizues në Rajonin e Prespës, gjatë viteve 1997-1999. Llojet me denduri më të madhe se 130 individë ishin Cërloi i Zi Pikalosh (*Sturnus vulgaris*), Kërpngrënësi ose Gardalina e Kërpit (*Carduelis cannabina*), Gardalina (*Carduelis carduelis*) dhe Lauresha (*Alauda arvensis*). Në total, janë vrojtuar 1494 individë, sipas Fremuth et al (2008).

What are the most important vegetation zones?

Besides aquatic ecosystems, there are three vegetation zones correlating with the elevation of Prespa National Park:

- The Oak Zone (600 to 1200 metres),
- the Beech Zone (1200 to 1900 metre) and
- the Alpine Zone (from 1900 metres upwards).

Cilat janë zonat më të rëndësishme të bimësisë?

Përveç ekosistemeve ujore, janë edhe tre zona të bimësisë në përputhje me lartësinë e Parkut Kombëtar të Prespës:

- Zona e Dushqeve (600– 1200 m),
- Zona e Ahut (1200 – 1900 m) dhe
- Zona Alpine (nga 1900 m e lart).



Fig. 17: Vegetation zones in Prespa National Park (© E-C-O). / Zonat e bimësisë në Parkun Kombëtar të Prespës

Which Oak species characterize the Oak Zone in PNP?

Depending on elevation, soil and exposition, there is a variety of oak species in the oak zone: Downy Oak (*Quercus pubescens*) and Turkey Oak (*Quercus cerris*) grow on fresh and deep soil. Macedonian Oak (*Quercus trojana*) you can find on dry and stony ground and the Hungarian Oak (*Quercus frainetto*) prefers sandy and sour soil. Higher elevation with cooler climate is the habitat of Sessile Oak (*Quercus petraea*).

Cilët janë Dushqet që karakterizojnë zonën e Dushqeve në PKP?

Shumëllojshmëria e dushqeve të kësaj zone ndryshon në varësi të lartësisë mbi nivelin e detit, tokës dhe ekspozicionit ndaj diellit. Kështu Bungëbuta (*Quercus pubescens*) dhe Qarri (*Quercus cerris*) rriten në tokat e reja dhe të thella. Bujgëra (*Quercus trojana*) gjendet në mjedise të thata dhe me gurë, ndërsa Shparthi (*Quercus frainetto*) parapëlqen toka ranore të lagështa dhe acide. Kurse Bunga (*Quercus petraea*) rritet në habitatet e lartësive më të mëdha, ku temperaturat janë më të ulta.



Fig. 18: Sessile Oak (© MJ) / Bunga

How to differentiate the oak species by their leaves?

The Prespa oak species can be differentiated by their characteristic leaves. Can you name them?

A: *Quercus trojana* / Bujgër

B: *Quercus petrea* / Bungë

C: *Quercus cerris* / Qarri

D: *Quercus frainetto* / Shparthi

E: *Quercus pubescens* / Bungëbutë

Si të bësh dallimin e llojeve të Dushqeve duke u nisur nga ndryshimi i gjetheve të tyre?

Llojet e Dushqeve të Prespës mund të përcaktohen nga karakteristikat e gjetheve të tyre. A mundesh ta bësh këtë lidhje?




Fig. 19: Various oak species in Prespa National Park (© Glatz-Jorde) / Lloje të ndryshme dushqesh në Parkun Kombëtar të Prespës

Which other vegetation elements are important in the oak zone?

Besides the name giving oaks, there are other typical tree species composing the oak zone:

Oriental Hornbeam (*Carpinus orientalis*), Hop Hornbeam (*Ostrya carpinifolia*) and Flowering Ash (*Fraxinus ornus*) are typical tree species of the oak zone. At higher elevations, Hornbeam (*Carpinus betulus*) can be found. At dry and rocky places, which are exposed towards south, some remarkable Grecian Juniper (*Juniperus excelsa*) trees grow.

In between there are dry grasslands and pastures including some protected species like Burning Bush (*Dictamnus albus*).



Cilët janë elementët e tjerë bimorë të rëndësishëm të zonës së Dushqeve?

Përveç dushqeve, prej të cilëve kjo zonë merr edhe emrin, ka bimë të tjera tipike drunore që janë pjesë përbërëse e zonës së Dushqeve:

Shkoza e Zezë (*Carpinus orientalis*), Mëllezja (*Ostrya carpinifolia*) dhe Frashëri i Zi (*Fraxinus ornus*) janë bimë tipike drunore të zonës së Dushqeve. Shkoza e Bardhë (*Carpinus betulus*) gjendet në lartësi më të mëdha. Ndërsa në vende të thata dhe shkëmbore të kundrejtura nga jugu rritet Venja e mrekulueshme *Juniperus excelsa*.

Midis tyre ka mjaft toka të thata me bar dhe kullota, tek të cilat rriten edhe lloje të mbrojtura bimore si për shembull: Disheli (*Dictamnus albus*).

Fig. 20: The Flowering Ash (*Fraxinus ornus*) / Frashëri i Zi

What is the Phrygana or “Shiblyak”?

At degraded stages of the forest in the oak zone close to the villages there is the Phrygana or “Shiblyak” – with shrubs like Common Hawthorn (*Crataegus monogyna*), Cornelian Cherry (*Cornus mas*), Common Hazel (*Corylus avellanea*), Common Juniper (*Juniperus communis*) and Common Box (*Buxus sempervirens*). Additionally, there are shrub-like oak trees, caused by overgrazing or frequent cutting.

Çfarë është Phrygana ose “Shiblaku”?

Në zonën e dushqeve, pikërisht pranë fshatrave vërehen etapat e degraduara të pyjeve, të përfaqësuara nga Shiblaku – me tërësinë e shkurretave: Murrizi i Heldrahit (*Crataegus monogyna*), Thana (*Cornus mas*), Lajthia (*Corylus avellanea*), Dëllinja e zezë (*Juniperus communis*) dhe Bushi (*Buxus sempervirens*). Kjo gjëndje shkaktohet edhe nga shfrytëzimi i pakontrolluar apo prerja e shpeshtë e tyre.



Fig. 21: Typical degraded landscape in Prespa National Park (©MJ) / Peizazh tipik i degraduar në Parkun Kombëtar të Prespës

What are the characteristics of the vegetation of the beech zone?

The beech Zone in Prespa NP is limited to the less hot and more humid eastern slopes of Mali I Thate. Beyond beech trees there are maple trees (*Acer obtusatum* and *Acer pseudoplanatus*) and the Turkish hazel (*Corylus colurna*), which is threatened with extinction.

In between there are meadows and pastures classified as dry grasslands and semi dry grasslands with many plant species and herbs.



Cilat janë karakteristikat e bimësisë së zonës së Ahut?

Zona e ahut të PKP kufizohet nga shpatet lindore të Malit të Thatë, të cilat janë më të freskëta dhe më të lagështa. Përveç aheve gjendet edhe panja (*Acer obtusatum*), panja e malit (*Acer pseudoplanatus*) dhe Lajthia e egër (*Corylus colurna*), e cila është në rrezik zhdukje.

Midis tyre ka livadhe të thata dhe gjysëm të thata, si edhe kullota, tek të cilat rritet një shumëllojshmëri barërash dhe bimësh mjekësore.

Fig. 22: Forrest impressions and a maple tree in spring/ Pamje e pyllit dhe gjethet e një Panje në pranverë

Which plant species are those?



Mediterranean Spurge/(©MJ)
Rriell moçalesh
(*Euphorbia characias*)

Si quhen këto bimë?



